

Sherife Hoxha
Audituese Ligjore, Licenca Nr 338
Adresa: Rr "Islam Alla", Pall 51, kati i 1-re, zyra 9, Tirane
Mob. +355 (0)67 260 9703
e-mail: hoxha_sherife@yahoo.com;

Tiranë, më 29.08.2021

Lënda: Kërkesë për fillimin e procedurave të auditimit ligjor.

Për: Partinë Agrare Ambientaliste e Shqipërisë.

Drejtuar: Kryetarit të Partisë "Agrare Ambientaliste e Shqipërisë" z. Agron Duka.

Adresa e selisë: Rruga " Pjetër Budi", nr 6, Tiranë.

Adresa personale: Rr "Pavarësia", lagjia nr 13, shtëpia nr 227, kodi postar 2008, Plazh, Durrës.

Per Dijeni: Financieri i Partisë "Agrare Ambientaliste e Shqipërisë" zj. Rozarta Kore.

Adresa : Rruga " Pjetër Budi", pallati nr 70, shk nr 2, ap nr 33, Tiranë.

Me vendimin të Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve (KQZ) nr. 425, datë 12.07.2021, jemi caktuar me cilesine e ekspertit kontabël të regjistruar (audituesit ligjor) për auditimin e fondeve të përftuara dhe të shpenzuara nga Partia "Agrare Ambientaliste e Shqipërisë" për vitin kalendarik 2020, të deklaruara në raportin financiar vjetor dhe në raportime të tjera financiare dorëzuar KQZ-së për këtë periudhë.

Sipas kontratës me nr prot 6281 datë 23.08.2021, me Komisionin Qendror te Zgjedhjeve (KQZ-në), objekti i misionit të auditimit është: "Kryerja e auditimit ligjor të detyrueshëm të fondeve të përftuara dhe të shpenzuara gjatë vitit kalendarik 2020, nga partitë politike në përputhje me ligjin nr. 8580, datë 17.02.2000 "Për partitë politike", i ndryshuar, aktet nënligjore të KQZ-së të miratuara për këtë qëllim, ligjin nr. 10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratur", i ndryshuar, dhe ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", se dhe aktet nënligjore të nxjerra në bazë dhe për zbatim të tyre". Afati i përfundimit të procesit te auditimit është 23 Shtator 2021.

Për kryerjen me sukses të misionit, brenda afatit të përcaktuar në kontraten e nënshkruar me KQZ-në. ne presim bashkëpunim tuaj dhe të personelit qe merret me shërbimin kontabël për të na bërë të disponueshëm dokumentacionin kontabël, regjistrimet dhe informacione të tjera që do të kërkohen në lidhje me auditimin tonë.

Ju lutem konfirmoni marrjen e kërkesës dhe na krijoni mundësinë e një takimi në selinë e partisë tuaj sa me shpejt të jetë e mundur, për të përcaktuar termat e angazhimit të auditimit.

Presim përgjigjen tuaj, (në adresën në krye të shkresës)

Faleminderit!

Audituesi Ligjor (Ekspert Kontabël i Regjistruar)

Sherife Hoxha


Tiranë, më 16.09.2021

Lënda: Informacion për auditimin e Partisë "Agrare Ambjentaliste"

Për: Komisionin Qëndror të Zgjedhjeve
Rruga "Ibrahim Rugova", Nr. 4, Tiranë, Shqipëri

Të nderuar zotërinj,

Me vendimin të Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve (KQZ) **nr. 425, datë 12.07.2021**, jemi caktuar me cilesine e ekspertit kontabël të rregjistruar (audituesit ligjor) për auditimin e fondeve të përftuara dhe të shpenzuara nga Partia **"Agrare Ambjentaliste" për vitin kalendarik 2020**, të deklaruar në raportin financiar vjetor dhe në raportime të tjera financiare dorëzuar KQZ-së për këtë periudhë.

Sipas kontratës me nr **prot 6281 datë 23.08.2021**, me Komisionin Qendror te Zgjedhjeve (KQZ-në), objekti i misionit të auditimit është: *"Kryerja e auditimit ligjor të detyrueshëm të fondeve të përftuara dhe të shpenzuara gjatë vitit kalendarik 2020, nga partitë politike në përputhje me ligjin nr. 8580, datë 17.02.2000 "Për partitë politike", i ndryshuar, aktet nënligjore të KQZ-së të miratuara për këtë qëllim, ligjin nr. 10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratur", i ndryshuar, dhe ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", se dhe aktet nënligjore të nxjerra në bazë dhe për zbatim të tyre"*. Afati i përfundimit të procesit të auditimit është **23 Shtator 2021**.

Pasi arritem komunikimin zyrtar me kryetarin e Partise se **"Agrare Ambjentaliste"** z. Agron Dukai morem deklarimet e kesaj partie qe nuk ka patur aktivitet dhe nuk ka perfituar fonde apo ka bere shpenzime per periudhen 01 janar 2020 -31 dhjetor 2021 . Ne seline e partise Agrare u gjeten pasqyrat financiare te vitit 2020, qe do i bashkangjiten ketij informacioni.

Partia "Agrare Ambjentaliste" sipas deklarimeve te bera nga kryetari i Kesaj Partie z. Arben Duka ka pergatitur Pasqyra Financiare per vitin kalendarik 202, me vlera zero pasi nuk ka pasur asnje lloj aktiviteti per vitin 2020.

Bashkengjitur ketij informacioni keni edhe Deklarimet e Partise se **"Agrare Ambjentaliste"** te firmosur e vulosur nga Kryetari i Partise se z. Agron Duka, dhe pasqyrat financiare te vitit 2020 te pergatitura nga subjekti.

Faleminderit për mirkuptimin!

Audituesi Ligjor(Ekspert Kontabël i Regjistruar)

Sherife HOXHA



Emertimi

Partia Agrare Ambientaliste e Shqiperise

NIPT -i

K72314451G

Adresa e Selise

Rr. "Pjeter Budi", Nr 6 Tirane

TIRANE

Data e krijimit

14/01/2007

Forma Ligjore

Veprimtaria Kryesore

Parti Politike

PASQYRAT FINANCIARE

(Ne zbatim te Standartit Kombetar te Kontabilitetit per OJF)

Ligjit Nr. 9228 Date 29.04.2004 Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare)

Viti 2020

Pasqyra Financiare jane individuale
Pasqyra Financiare jane te konsoliduara
Pasqyra Financiare jane te shprehura ne
Pasqyra Financiare jane te rumbullakosura ne

PO

JO

LEKE

JO

Periudha Kontabel e Pasqyrave Financiare

Nga 01.01.2020

Deri 31.12.2020

Data e mbylljes se Pasqyrave Financiare

31/03/2021

Shtojca 2

Shoqata Ujesielles e Kanalizime e Shqiperise

Pasqyra e Performaces 31.12.2020

(Shpenzimet të paraqitura sipas funksionit)

Nr	Pershkrimi i zerit	Periudha Raportuese	Periudha Para ardhese
	Ndryshimi në aktivet neto të pakufizuara:		
	Te ardhurat		
	Të ardhura nga tarifat e anëtarësimit		
	Të ardhura nga trajnimet		
	Të ardhura nga programe		
	Të ardhura nga Konferencat dhe ekspozita		
	Të ardhura nga donacione (projekte)		
	Të ardhura të tjera		
	Totali i të ardhurave nga aktivet neto të pakufizuara		
	Aktive neto të çliruara nga kufizimet:		
	Aktive neto të çliruara nga kufizimet:		
	Realizimi i kufizimeve të programit		
	Realizimi i kufizimit për blerjen e pajisjeve		
	Përfundimi i kufizimit të afatit		
	Totali i aktiveve neto të çliruara nga kufizimet		
	Totali i të ardhurave nga aktivet neto të pakufizuara:		
	Shpenzime për aktivitetet		
	Aktiviteti A		
	Aktiviteti B		
	Aktiviteti C		
	Shpenzime administrimi dhe të tjera të përgjithshme		
	Krijim dhe rritje fondesh		
	Totali i shpenzimeve		
	Rritja/Rënia në aktivet neto të pakufizuara (A)		
	Ndryshimi në aktivet neto të kufizuara:		
	Kontributet		
	Të ardhurat nga investimet afat gjata		
	Fitimi i realizuar dhe i parealizuar nga investimet afatgjata		
	Humbja aktuariale nga obligacioni vjetor		
	Aktivete neto të çliruara nga kufizimet (me shenjë minus)		
	Rritja/Rënia në aktivet neto përkohësisht të kufizuara (B)		
	Ndryshimi në aktivet neto (A + B)		
	Aktive neto në fillim të vitit		
	Aktive neto në fund të vitit		

Shtojca 3

Shoqata Ujesjelles e Kanalizime e Shqiperise

Pasqyra e Flukseve te Mjeteve Monetare 31.12.2020

Metoda Indirekte

Nr	Pershkrimi i zerave	Periudha Raportuese	Periudha Para ardhese
	Ndryshimet në aktivet neto	-	
	Rregullimet për përputhjen e ndryshimeve në aktivet neto me flukset neto nga aktivitetet e shfrytëzimit:		
	Amortizimi dhe zhvlerësimi	-	
	Humbjet e realizuara dhe të parealizuara në investime		
	Humbjet nga dalja jashtë përdorimit e makineri pajisjeve		
	Kontributet jo në para		
	Rritjet / Rëniet jo në para të inventarëve		
	Kontributet e kufizuara për investime në dhurime / ndihma		
	Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet afatshkurtra:		
	Të tjera të arkëtueshme	-	
	Shpenzime të parapaguara		
	Bamirësi në mirëbesim të arkëtueshme		
	Të pagueshme		
	Bamirësi mbi baza vjetore		
	Flukse neto nga aktivitetet e shfrytëzimit	-	
	AKTIVITETET INVESTUESE		
	Blerje / Shitje investimesh		
	Blerje / Shitje e Aktiveve afatgjata		
	Principal i arkëtuar nga dëftesat e arkëtueshme		
	Të arkëtuara në avancë nga dëftesa të arkëtueshme		
	Flukse neto nga aktivitetet investuese		
	AKTIVITETET FINANCUESE		
	Arkëtime nga kontributet e kufizuara për investime në dhurime / ndihma		
	Principal i paguar për dëftesat e pagueshme		
	Flukse neto nga aktivitetet financuese		
	Rritje / Rënie neto e mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre		
	Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre në fillim të periudhës		
	Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre në fund të periudhës		
	Mjete monetare të paguara gjatë periudhës për interesa		
	Mjete monetare të paguara gjatë periudhës për tatim taksa		

SHENIMET SHPJEGUESE

Sqarim:

Dhënia e shënimeve shpjeguese në këtë pjesë është e detyrueshme sipas SKK 10
Plotesimi i te dhenave të kësaj pjese duhet të bëhet sipas kërkesave dhe strukturës standarte të
percaktuara në SKK 10 Grantet dhe format e tjera të ndihmes miratuar nga KKK dhe i shpallur nga MF

- a) Objektivi dhe baza e përgatitjes
- b) Shënimet që shpjegojnë zërat e ndryshëm të pasqyrave financiare
- c) Njohja dhe matja e granteve

A | OBJEKTIVI DHE BAZA E PëRGATITJES

Objektivi I SKK 10 është dhënia e parimeve të njohjes, matjes dhe vlerësimit të mëposhtem të granteve dhe formave të tjera të ndihmes në PF të përgatitura në përputhje me SKK-te. Këto standarte bazohen në parimet e kontabilitetit dhe raportimit të pranuar në shkallë ndërkombëtare, kërkesat e përgjithshme të cilave përkruhen në Ligjin nr.9228 date 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", publikuar në prill 2004, i ndryshuar. Objektivi PF është dhënia e informacionit rreth pozicionit financiar, performancës dhe fluksit të mjeteve monetare të OJF-ve të dobishëm për qëllime të përgjegjësive dhe vendimmarrjes së përdoruesve të këtyre PF.

PF japin një pamje të vertete dhe të drejte të pozicionit financiar, performancës dhe fluksit të mjeteve monetare të OJF-se, vetëm dhe vetëm nëse:

- a) ato janë të sakta dhe të plota në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike;
- b) përgatitja e tyre bazohet në vlerësime të arsyeshme e të bazuara;
- c) shenimet në PF janë përgatitur me detaje të mjaftueshme për të dhënë një pamje të përgjithshme të pozicionit financiar, performancës dhe fluksit të mjeteve monetare të OJF-se.

B | SHENIMET QË SHPJEGOJNË ZËRAT E NDRYSHËM TË PASQYRAVE FINANCIARE (PF)

Në shenimet shpjeguese paraqitet informacioni i mëposhtem në lidhje me grantet dhe ndihmat të tjera:

- a) natyra dhe shumica e granteve të njohura në PF;
- b) kushtet e përbashkëta dhe detyrimet e kushtezuara të lidhura me grantet që nuk kanë qenë të njohura në të ardhmen;
- c) një përshkrim të formave të tjera të ndihmes qeveritare ose joqeveritare nga të cilat njësia ekonomike ka përfituar drejtpërdrejt

C | NJOHJA DHE MATJA E GRANTEVE

Njësia ekonomike I njeh grantet si vijon:

- a) një grant që nuk imponon kushte të specifikuar të performancës në të ardhmen mbi përfituesin njihet në të ardhura kur granti është arketuar;
- b) një grant që imponon kushte të specifikuar të performancës në të ardhmen mbi përfituesin njihet në të ardhura kur kushtet e performancës janë plotësuar;
- c) Grantet e marra para se të plotësohet kriteri i njohjes së të ardhurave njihen si detyrim

Hartuesi I Bilancit

Kryetari I Partise
Agron Duka

Agron Duka



Partia "Agrare Ambientaliste"

Tirane, më 09.09.2021

Deklarimet e Partisë "Agrare Ambientaliste"

Për audituesen Ligjore : Zj. Sherife Hoxha

Kjo letër e deklarimeve jepet në përgjigje të kërkeses tuaj date 29.08.2021 për informacion në lidhje me kryerjen e auditimit ligjor të detyrueshëm të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara gjatë vitit kalendarik 2020, nga partia "Agrare Ambientaliste", autorizuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Lidhur me kërkesen dhe informacionin e kërkuar nga ana juaj une, Agron Duka kryetar i kesaj partie, deklaroj me pergjegjesi te plote se Partia "Agrare Ambientaliste " gjate periudhes 1 Janar 2020-31 Dhjetor 2020:

- Nuk ka patur hyrje nga asnje burim të ardhurash, si kuotat e antarësise, financime nga buxheti i shtetit, financime nga donatore te huaj dhe vendas, hua, burime në natyre apo kompesime shpenzimesh.
- Nuk ka pasur burime materiale dhe financiare të trashiguara nga viti 2019.
- Nuk ka realizuar asnje blerje mallrash e sherbime për llogari të partise nga operatorë tregtarë dhe individ dhe nuk kemi berë pagesa ndaj tyre.
- Nuk ka pasur të punesuar dhe për rrjedhim shpenzime për paga dhe sigurime shoqerore e shendetesore.
- Nuk ka kontrata për ambiente me qera apo huaperdorje.
- Nuk ka të hapur asnje llogari bankare ne bankat qe veprojne ne shqiperi dhe jashte saj, per vitin kalendarik 2020.

Ne kushtet e mungeses së transaksioneve ekonomike dhe financiare nuk kemi dorezuar Pasqyrat Financiare me vlere zero që kerkohen nga KQZ-ja apo nga institucione te tjera shteterore për vitin 2020.

Konfirmoj vërtetësinë e të dhënave të paraqitura në këtë dokument.

Për Partinë "Agrare Ambientaliste"

Agron Duka

